

НУБ “Коџо Раџин”- Тетово



INB “Коџо Раџин”- Tetovë



THIRRJE PËR PJESËMARRJE NË
KONFERENCËN E PARË NDËRKOMBËTARE

“Ura e dijes: diversiteti, dialogu dhe inovacionet në bibliotekat bashkëkohore”

14–15 tetor 2026

INB “Коџо Раџин” – Tetovë, Republika e Maqedonisë së Veriut

Nëntemat:

- ✦ Diversiteti për përfshirje në shërbimet bibliotekare
- ✦ Roli i bibliotekave në nxitjen e dialogut dhe mirëkuptimit ndërkulturor
- ✦ Transformimi digjital dhe inovacionet në biblioteka
- ✦ Promovimi i leximit dhe i shkrim-leximit informativ
- ✦ Bibliotekat si qendra të të nxëniet gjatë gjithë jetës
- ✦ Bashkëpunimi dhe rrjetëzimi ndërmjet bibliotekave dhe institucioneve kulturore

Qëllimi i konferencës:

Të nxitet shkëmbimi i njohurive, përvojave dhe praktikave të mira ndërmjet bibliotekarëve, punonjësve shkencorë, studiuesve dhe të gjithë profesionistëve që veprojnë në fushën e veprimtarisë bibliotekare dhe informative.

Datat e rëndësishme:

- 📅 Afati për dorëzimin e abstrakteve: **10.07.2026**
- 📅 Njoftimi për abstraktet e pranuar: **31.07.2026**
- 📅 Afati i fundit për dorëzimin e punimeve: **10.09.2026**
- 📅 Afati i fundit për pjesëmarrje pa punim: **10.09.2026**

Kontakt:

- ✉ Dërgoni abstraktet tuaja në: bibliotekatetove@gmail.com
- 👤 Persona kontakti: Gjulten Ajruli, Ganimet Elmazi
- ☎ Telefon: +389 73 273 970; +389 78 306 996
- 📘 Më shumë informacione: info@nubkrte.org.mk; biblioteka@nubkrte.org.mk

STRUKTURA E ABSTRAKTIT

Titulli

(në qendër, 14 pt, Times New Roman, Bold)

Nën titull, në këndin e djathtë, të shënohen:

(10 Points Times New Roman, Italic):

-titulli akademik, emri dhe mbiemri i autorit/autorëve,

- institucioni i afilacionit të autorit/autorëve.

- të dhënat e kontaktit (e-mail, telefon)

Abstrakti

(në qendër, 11 Points Times New Roman, Bold)

Abstrakti kufizohet në maksimum 250 fjalë, në gjuhën amtare dhe në gjuhën angleze. Ai paraqitet në një paragraf të vetëm dhe përmbledh elementet më të rëndësishme të artikullit. (11 Points Times New Roman)

Fjalë kyçe: 5–7 fjalë kyçe. (11 Points Times New Roman, Italicize Each Word)

Gjuhët zyrtare të Konferencës: maqedonisht, shqip dhe anglisht.

Prezantimet e punimeve në Konferencë duhet të përgatiten në PowerPoint, në gjuhën amtare dhe angleze, me kohëzgjatje maksimale prej 10 minutash.

Këshilli redaktues:

- mr. Milka Kotevska, bibliotekare e lartë, INBU “Shën Klimenti i Ohrit” – Manastir
- mr. Elizabeta Trpçeska Petrushevska, bibliotekare- këshilltare, INB “Koço Racin” – Tetovë
- mr. Elmedina Abdullahi, bibliotekare e lartë, Biblioteka “Max van der Stoel” – Tetovë, UEJL

UDHËZIME PËR AUTORËT

Këshillit Redaktues të Konferencës mund t'i dërgohen vetëm punime origjinale (të papublikuara më parë), të cilat përputhen me temën dhe nën-temat e konferencës, të përgatitura dhe të rregulluara teknikisht sipas këtyre udhëzimeve. Pas shqyrtimit të punimeve të plota dhe në bazë të kriterëve të publikuara, Këshilli Redaktues do të vendosë se cilat punime do të prezantohen në konferencë dhe cilat do të publikohen vetëm në formë elektronike dhe të shtypur.

RREGULLIMI TEKNIK I PUNIMEVE / ARTIKUJVE

1. Margjinat: Top - 2,54 cm, Down - 2,54 cm, Left - 3 cm, Right - 2,5 cm, Gutter - 0 cm, Header - 1,25 cm, Footer - 1,25 cm. Teksti duhet të shkruhet me hapësirë ndërmjet rreshtave 1,5 (1.5 line spacing), me font Times New Roman, madhësia 12.
2. Përveç faqes së parë, punimi nuk duhet të përmbajë emrin e autorit në faqet e tjera.
3. Citimet dhe shënimet duhet të vendosen në fund të faqes (footer/footnotes) dhe të numërohen në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë, me madhësi fonti 10.
4. Tabelat, grafikët dhe ilustrimet e tjera duhet të kenë titull dhe të jenë të numëruara në mënyrë të njëpasnjëshme me numra arabë, në stil kursiv.
5. Është e detyrueshme të përfshihen të gjitha burimet bibliografike të përdorura gjatë përgatitjes dhe shkrimit të punimit.

Për librat:

Mbiemri, inicialet. (Viti). Titulli i librit. Botimi (nëse nuk është botimi i parë). Vendi i botimit: Botuesi.

Për artikuj në revista shkencore:

Mbiemri, inicialet. (Viti). "Titulli i artikullit". Emri i revistës shkencore, vëllimi (numri), faqet.

Për burimet elektronike:

Nëse burimi është i disponueshëm online, referenca fillon me të dhënat bibliografike, ndërsa në fund shënohet adresa e plotë e internetit (URL), si dhe data e qasjes në burim.

STRUKTURA E PUNIMIT / ARTIKULLIT

Titulli

(në qendër, 14 Points Times New Roman, Bold)

Nën titull, në këndin e djathtë, të shënohen:

(10 Points Times New Roman, Italic):

- titulli akademik, emri dhe mbiemri i autorit/autorëve,
- institucioni i afilacionit të autorit/autorëve.
- të dhënat e kontaktit (e-mail, telefon)

Abstrakti

(11 Points Times New Roman, Bold)

Abstrakti kufizohet në maksimum 250 fjalë, në një paragraf të vetëm, duke përmbledhur elementet më të rëndësishme të artikullit. (12 Points Times New Roman)

Fjalë kyçe: 5–7 fjalë kyçe. (11 Points Times New Roman, Italic)

Pjesa kryesore e tekstit (12 Points Times New Roman, me hapësirë të vetme ndërmjet rreshtave)

Referencat (10 Points Times New Roman, me hapësirë të vetme ndërmjet rreshtave)

Përmbledhje (Summary) dhe fjalë kyçe në gjuhën angleze.